



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.2.2024

Nr: 11

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË RROGOZHINË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË”, ZJ. MERILIN ARTUR SARAÇI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4268 prot., datë 22.11.2023, Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Bajazit Idriz Thaçi, propozuar nga subjekti politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Merilin Artur Saraçi.

Me shkresën nr. 7843, prot., datë 13.12.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, zj. Merilin Artur Saraçi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 2.2.2024 Nr: 11
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e bashkisë Rrogozhinë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, zj. Merilin Artur Saraçi”.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 45 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Merilin Artur Saraçi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 7967 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7968 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Merilin Artur Saraçi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 18828/1 prot., datë 11.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Merilin Artur Saraçi, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 16934/1 prot., datë 12.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Merilin Artur Saraçi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Merilin Artur Saraçi, në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, zj. Merilin Artur Saraçi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI